

## **GRUPI I PUNËS SË MBROJTJES SË TË DHËNAVE TË NENIT 29**

### **DEKLARATË E PËRBASHKËT E AUTORITETEVE EVROPIANE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE TË MBLEDHURA NË GRUPIN E PUNËS SË NENIT 29**

**Miratuar më 26 Nëntor 2014**

Grupi i Punës u ngrit sipas Nenit 29 të Direktivës 95/46/EC. Ai është një organizëm evropian këshillues i pavarur në lidhje me mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë. Detyrat e tij parashikohen në Nenin 30 të Direktivës 95/46/EC dhe Nenin 15 të Direktivës 2002/58/EC.

Sekretariati kryhet nga Drejtoria C (Të Drejtat Themelore dhe Shtetësia e Unionit) të Komisionit Evropian, Drejtoria e Përgjithshme e Drejtësisë, B-1049 Bruksel, Belgjikë, Nr. i Zyrës MO-59 02/013.

Faqja e internetit: <http://ec.europa.eu/justice/data-protection/indexen.htm>

## Hyrje

Jeta jonë e përditshme është gjithnjë e më tepër digjitale. Në më pak se një dekadë, aktivitetet profesionale, ekonomike dhe private janë zhvendosur gradualisht drejt ambientit digjital. Ky evolucion ka hapur një botë mundësish të reja dhe ka aktivizuar zhvillimin e mallrave dhe shërbimeve inovative të jashtëzakonshme, të cilat përmbushin nevojat individuale dhe kolektive. Të dhënat personale janë guri i themelit të kësaj bote digjitale.

Funksionimi i ambientit digjital mbështetet gjerësisht në infrastruktura informative komplekse të cilat janë zhvilluar prej njësisish private për nevojat e tyre personale. Këto njësi mbledhin sasi të mëdha të dhënash personale, të cilat mund të arkivohen, procedohen më tej dhe shpërndahen nga disa prej tyre, shpeshherë pa i lënë individit një nivel të mjaftueshëm kontrolli dhe jashtë çdo lloj forme mbikëqyrjeje të efektshme. Nga ana tjetër, siç kanë treguar zbulimet e fundit të Snoudenit, autoritetet publike dhe shërbimet e inteligjencës, kanë kërkuar akses masiv në këtë infrastrukturë të dhënash për qëllime të tjera, veçanërisht për sigurinë kombëtare.

Karakterit masiv dhe rutinë i këtij aksesi, ka tronditur publikun anembanë globit. Tashmë, sfida është të riparojmë krizën e besueshmërisë që kanë gjeneruar këto zbulime kundrejt qeverive (kombëtare dhe të huaja) dhe të shërbimeve të inteligjencës e të survejimit, ashtu si edhe problemin themelor mbi mënyrën e kontrollit të aksesit në sasi të masive të së dhënave personale. Si mund të ndërtohet një kuadër i cili u mundëson kompanive private dhe organeve të tjera të inovojnë dhe të ofrojnë mallra dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e konsumatorit dhe nevojat e publikut, duke u mundësuar ndërkohë shërbimeve kombëtare të inteligjencës, të zbatojnë misionet e tyre brenda kuadrit ligjor por duke shmangur survejimin mbarëshoqëror?

Për shkak të historisë dhe kulturës së saj të përbashkët, Evropa duhet të ngrejë zërin sa i takon garantimit të së drejtave themelore, përfshirë të drejtën për privatësi dhe mbrojtje të dhënash, që të respektohen pa penguar inovacionin ose nevojën për të garantuar sigurinë në shoqërinë tonë. Në këtë kontekst, Autoritetet e pavarura të Mbrojtjes së të Dhënave të mbledhura në Grupin e Punës së Nenit 29-të (WP29), duan të përcjellin disa mesazhe kyçe mbi mënyrën se si ta zgjidhim këtë sfidë globale.

Për rrjedhojë, Grupi i Punës së Nenit 29-të, në mbledhjen e tij plenare të 25 nëntorit 2014, ka miratuar deklaratën në vijim:

### Vlerat evropiane

1. **Mbrojtja e të dhënave personale është e drejtë themelore.** Të dhënat personale (të cilat përfshijnë metadat) mund të mos trajtohen vetëm si subjekt tregtie, aset ekonomik apo mall konsumi.
2. **Të drejtat e mbrojtjes së të dhënave duhet të balancohen me të drejtat e tjera themelore,** përfshirë mos-diskriminim dhe lirinë e shprehjes, të cilat kanë vlerë të barabartë në një shoqëri demokratike. Ato duhen balancuar me nevojën për siguri.

3. **Teknologjia është një mjet që duhet të mbesë në shërbim të njeriut.** Fakti se diçka është e mundshme teknikisht dhe se përpunimi i të dhënave mund të jetë i dobishëm ndonjëherë për zbulime, ose për të zhvilluar shërbime të reja, nuk do të thotë domosdoshmërisht se është i pranueshëm edhe shoqërisht, etnikisht, i arsyeshëm ose i ligjshëm.
4. **Besimi i publikut në produkte dhe shërbime të ekonomisë digjitale** varet gjerësisht në përputhshmërinë e industrisë teknologjike me rregullat e mbrojtjes së të dhënave. Kjo përputhshmëri është një faktor kyç konkurrueshmërie për ekonominë digjitale; ajo do të garantojë gjithashtu zhvillimin e qëndrueshëm të saj, si në dobi të saj ashtu edhe të konsumatorëve.
5. **Ndërgjegjësimi publik dhe të drejtat e njeriut** duhet të forcohen për t'i ndihmuar individët të kufizojnë ekspozimin e tyre ndaj riskut tëurvejimit të tepruar nga aktorë publikë dhe privatë. Në këtë drejtim, masa të rëndësishme po përmirësojnë edukimin digjital, përfshirë edukimin mbi privatësinë dhe aftësinë për të ndërmarrë veprime gjyqësore kolektive për të lehtësuar denoncimin e shkeljeve të përhapura të mbrojtjes së të dhënave.

#### **Survejsimi për qëllime të sigurisë**

6. **Survejsimi sekret, masiv dhe i përgjithshëm** i individëve në Evropë, qoftë nga aktorë publikë ose privatë që veprojnë në një Shtet anëtar të BE-së ose diku tjetër, nuk është as i ligjshëm kundrejt Traktateve dhe legjislacioneve të BE-së e as i pranueshëm në kuadrin etik.
7. **Aksesi në të dhënat me karakter personal për qëllime sigurie nuk është i pranueshëm në një shoqëri demokratike për sa kohë që është masiv dhe i pakushtëzuar.** Mbajtja, aksesimi dhe përdorimi i të dhënave nga autoritetet kombëtare kompetente duhet të kushtëzohet në atë çka është domosdoshmërisht e nevojshme dhe proporcionale në një shoqëri demokratike dhe të jetë subjekt i masave të efektshme të sigurisë materiale dhe procedurale.
8. **Përpunimi i të dhënave personale në kontekstin e aktiviteteve tëurvejimit** mund të kryhet vetëm me masa të përshtatshme sigurie të përcaktuara në ligj, në përputhje me Nenin 8 të Kartës Evropiane të së Drejtave Themelore. Në këto masa sigurie përfshihet **mbikëqyrja e pavarur dhe e efektshme**, në të cilat duhet të përfshihen realisht Autoritetet e Mbrojtjes së të Dhënave, brenda kufijve të kompetencave të tyre.
9. Si rregull, një autoritet publik i një vendi jo anëtar të BE-së, nuk duhet të ketë **akses të pakufizuar të drejtpërdrejtë në të dhënat e individëve të përpunuara nën juridiksionin e BE-së**, çfarëdo qofshin kushtet e këtij aksesimi dhe vendndodhja e këtyre të dhënave. Konfliktet e juridiksionit duhet të zgjidhen vetëm sipas disa kushteve – p.sh. nëpërmjet autorizimit paraprak të një autoriteti publik në BE ose nëpërmjet traktatesh dypalëshe të asistencës ligjore, që mbulojnë respektivisht aksesin e autoriteteve të huaja ligj-zbatuese në të dhënat e transferuara nga BE-ja ose në të dhënat që mbahen në BE. Kërkesat nga jashtë nuk duhet t'i drejtohen drejtpërdrejt kompanive të cilat janë nën juridiksionin e BE-së.

10. Asnjëra nga dispozitat e **instrumenteve evropiane të cilat synojnë inkuadrimin e transferimeve ndërkombëtare të së dhënave** ndërmjet palëve private nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për transferime të dhënash drejt autoritetesh të vendeve të treta, për qëllime survejimi masiv dhe të përgjithshëm – qofshin këto të sferës së sigurisë (“Safe Harbor”), rregullave të detyrueshme të korporatave (“BCR”) apo klauzolave kontraktuale standarde.
11. Kur palë publike apo private mbledhin sasi masive të dhënash, të cilat japin informacion tepër të saktë në lidhje me jetët private të individëve, të dhënat e të cilëve janë mbajtur, ato duhet të organizojnë mbajtjen e këtyre të dhënave në mënyrë të tillë që një autoritet i pavarur të mund të kontrollojë me efektshmëri përputhshmërinë e tyre me kërkesat e mbrojtjes së të dhënave. **Mbajtja e këtyre të dhënave në territorin e BE-së** është një mënyrë efektive për të lehtësuar ushtrimin e këtij lloj kontrolli.

### **Ndikimi Evropian**

12. **Draft - paketa e BE-së në lidhje me mbrojtjen e të dhënave duhet të miratohet në 2015-ën.** Ndërkohë që jep kontribut për unifikimin e tregut digjital evropiane, ai duhet gjithashtu të sigurojë nivel të lartë të mbrojtjes së të dhënave të individëve, në përputhje me vlerat dhe të drejtat themelore evropiane.
13. Niveli evropiane i mbrojtjes së të dhënave personale nuk duhet të cënohet, tërësisht apo pjesërisht nga **marrëveshjet dypalëshe ndërkombëtare, përfshirë marrëveshjet tregtare** për mallra e shërbime me vendet e treta.
14. Rregullat e mbrojtjes së të dhënave të BE-së janë të nevojshme për garantimin e situatës politike, shoqërore dhe ekonomike të BE-së dhe të atyre që i nënshtrohen legjislacionit të BE-së. Parimet e tyre duhet të konsiderohen se **janë të natyrës detyruese ndërkombëtarisht nën ligjin ndërkombëtar publik e privat.** Ligjet e huaja e marrëveshjet ndërkombëtare nuk mund t’i prevalojnë e as organizatat nuk mund t’u shmangen me anë të kontratave.
15. Ekuilibri që duhet vendosur ndërmjet mbrojtjes së të dhënave, inovacionit dhe survejimit, nuk do të thotë **as se duhen ndërtuar kufij të brendshëm në BE e as se duhen mbyllur portat e Evropës** për partnerët e huaj. Ai kërkon respekt të nivelit të lartë mbrojtjes që rrjedh nga trashëgimia evropiane e mbrojtjes së të dhënave, përfshirë Konventën 108 të Këshillit të Evropës dhe rregullat e mbrojtjes së të dhënave të BE-së.

Hapat e mëtejshëm

16. Grupi i punës mirëpret **komentet** në lidhje me këtë Deklaratë nga të gjithë aktorët e interesuar, qofshin publikë apo privatë. Këto komente mund të adresohen nëpërmjet faqes së internetit të dedikuar në dispozicion tek [www.europeandatatagovernanceforum.com](http://www.europeandatatagovernanceforum.com). Grupi i Punës do t'i marrë në konsideratë këto komente gjatë aktiviteteve të tij të viti 2015.